

# INFORMACIONE



## KOMITETI OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR

### PASQYRA E AKTIVITETEVE

<b>9 Prill 2004</b>	<b>KOKSH - Mbledhje e Komitetit Ekzekutiv VLORE</b>
<b>10 Prill 2004</b>	<b>« ASAMBLEA 9 VJETORE e KOKSH» VLORE</b>
<b>13 Prill 2004</b>	<b>KOMPAS II – Mledhje Tutorëve</b>
<b>15-18 Prill 2004</b>	<b>Konferenca e I-rë Shkencore Ndërkombëtare Tivar - Mali Zi</b>
<b>16-18 Prill 2004</b>	<b>Asamblea e Përgjithëshme e ENGSO/ Beograd</b>
<b>21-24 Prill 2004</b>	<b>Kursi Lokal I Administratorëve të Sportit / Lezhë</b>
<b>22-29 Prill 2004</b>	<b>Sesioni 7 i AON</b>
<b>25 Prill 2004</b>	<b>KOMPAS II</b>
<b>27 Prill 2004</b>	<b>KOKSH takim me UNDP</b>
<b>27-29 Prill 2004</b>	<b>KOKSH &amp; AEFS - Vizita Makolin, Zvicër</b>

# PRILL 2004

## VLORE, 9 Prill 2004

### Mbledhje e Komitetit Ekzekutiv

U zhvillua mbledhja e anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv. Objekti i kësaj mbledhje ishte rreth organizimit dhe mbarvajtjes së « Asamblesë 9-të Vjetore e KOKSH ».

## VLORE, 10 Prill 2004

### « ASAMBLEA 9 VJETORE e KOKSH »

Në qytetin e Vlorës u zhvillua Asamblea 9-të vjetore e KOKSH. Fjala përshëndetëse e Presidentit të KOKSH z.Hysen Domi hapi siparin e Asamblesë. E nderoi Asamblesën edhe prezenca dhe fjala përshëndetëse e Kryebashkiakut të Vlorës z.Shpëtim Gjika.

Në këtë aktivitet morrën pjesë Presidentët dhe Sekretarët e Federatave sportive anëtarë të KOKSH. Një tjetër aspekt i rëndësishëm i këtij aktij aktiviteti ishin Urdhërat Olimpik të cilët iu dhanë figurave të shquara të sportit :



**Enver Maçi, Feti Borova, Sofie Meço, Flora Toto, Todi Janku dhe Shpëtim Gjika**

Pas fjalës së z. Domi, Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH z. Stavri Bello bëri një rezymë të të gjithë punës dhe arritjet që KOKSH ka realizuar për vitin 2003 dhe objektivat për 2004. Në këtë Asamble u prezantuan raportet e Komisioneve të KOKSH për punën e bërë për përhapjen e lëvizjes Olimpikë dhe atë sportive. Raportet që u prezantuan nga kryetarët e këtyre komisioneve u mbajtën sipas rendit të ditës :

**Stavri Bello** Mbi veprimtarinë e KOKSH për vitin 2003

*Raportet e komisioneve të KOKSH*

**Fidel Ylli** - Komisioni Teknik

**Gëzim Panariti** - Komisioni Financë-Marketing

**Durim Tabaku** - Komisioni Fair Play

**Lluka Heqimi** - Komisioni Mjekësor

**Ilija Gaxho** - Komisioni « Sporti për të gjithë »

**Ela Tase** - Komisioni « Femra dhe Sporti »

**Sali Preçi** - Kontrolli Financiar

**Skënder Begeja** - Këshilli Arbitrimit Sportiv

**Arben Kaçuri** - Akademia Olimpikë

Në përfundim, Presidenti i KOKSH z.Hysen Domi shtroi dreqën e rastit e cila shënoi dhe mbylljen e edicionit IX të Asambleve Vjetore të KOKSH.

## 13 Prill 2004

### KOMPAS II – Mledhje Tutorëve

U zhvillua takimi i dytë i tutorëve të KOMPAS II në të cilën u analizua ecuria e deritanishme dhe gjithashtu u morën disa disa vendime lidhur me mbarëvajtjen e kursit.

## 16-18 Prill 2004 Beograd

### Asambleja e Përgjithëshme e ENGSO

Në qytetin e Beogradit në Serbi – Mali Zi u zhvillua Asambleja e 12-të e Përgjithëshme e ENGSO-s. të gjitha mbledhjet e kësaj Asambleje u mbajtën në Hotel Internacional Beograd.

Në këtë Asamble, KOKSH pati fatin të përfaqësohej me z. Arben Jorgoni dhe z. Adriatik Meta.

Në Asamble u paraqit puna e bërë dhe arritjet nga ENGSO për vitin 2003 dhe objektivat për 2004.

Përfaqësuesit tanë, në mënyrë aktive, morrën pjesë në diskutime të ndryshme për çështjet që shqetësojnë sportin dhe politikën për zhvillimin e tij.

## 15-18 Prill 2004 Tivar - Mali Zi

### Konferenca e I-rë Shkencore Ndërkombëtare

për tre ditë u zhvillua Konferenca e I-rë Shkencore Ndërkombëtare me temë :

« Sporti në shekullin e 21-të ». Morrën pjesë përfaqësues nga Universitetet e Beogradit, Sarajeva, Nish, Maqedonia, Rusia etj. KOKSH u përfaqësua me Pro.Dr. Bahri Ishka ku ishte në rolin e vëzhguesit. U referuan 58 referate shkencore, por u bënë edhe diskutime të hapura sidomos për tu përmendur tema « Ekonomia – Sporti – Turizmi ».

## 21-24 Prill 2004 Lezhe Kursi Lokal I Administratorëve të Sportit

KOKSH organizoi Kursin Lokal të Administratorëve të sportit në Prefekturën e Lezhës, i mbështetur dhe financuar nga Solidariteti Olimpik me qëllim rritjen e aftësisë menaxhuese të Drejtusve të sportit.

Ky kurs trainoi 14 meshkuj dhe 7 femra drejtues dhe inspektorë sporti nga zonat që mbulon kjo Prefekturë (Lezhë, Laç dhe Rrëshen). Ky kurs u drejtua nga lektorë të aprovuar nga CIO, me tema për menaxhimin në sport dhe përhapjen e frymës olimpike.



### Lektorët :

H.Domi, S.Bello, L.Tase, G.Panariti, A.Kaçurri, F. Ylli, A. Jorgoni, E.Gjoka, V. Shqevi

Pjesmarrësit u pajisën me një manual të posaçëm për administrimin në sport dhe materiale shtesë.

## 22-29 Prill 2004 Sesionin 7 i AON

Sesionin 7 i Përbashkët Ndërkombëtar I Presidentëve dhe Drejtorëve të Akademive Olimpikë Kombëtare dhe Zyrtarëve të Komiteteve Olimpikë Ndërkombëtare.

Ky sesion u mbajt në qytetin e Olimpias në Qendrën Ndërkombëtare të Akademisë Olimpikë dhe KOKSH u përfaqësua me z. Arben Kaçurri, drejtor i AO dhe z. Ilia Gaxho.

## 25 Prill 2004 KOMPAS II

U zhvillua seanca e shtatë e Kursit Olimpik të Menaxhimit për Administratorët e Sportit KOMPAS II.

Këtë seminar e drejtoi specialisti italian i « Scuola dello Sport » z. Fabrizzio Biffi.

Çështjet që u pasqyruan në këtë seminar ishin mbi « Administrimin e Federatave Sportive » dhe Struktura e Organizimit midis CONI-it dhe Federatave Sportive.



## 27 Prill 2004 Takim me UNDP

Sekretari I Përgjithshëm I KOKSH z.Stavri Bello zhvilloi një takim me përfaqësues të UNDP lidhur me projektin « Zhvillimi nëpërmjet Sportit ».

## 27-29 Prill 2004 Vizita Makolin, Zvicër

Me ftesë të Komitetit Olimpik Zviceran dhe Sekretarit të Përgjithshëm Marko Blatter, një delegacion zyrtar I KOKSH I përbërë nga Sekretari I Përgjithshëm z. S.Bello, Rektori I AEFS « Vojo Kushi » z. S.Shtepani dhe zv.Rektori z. B.Misja zhvilloi një vizitë pune dy ditore në ZYREN FEDERALE TE SPORTEVE TE MAKOLINIT (Zvicër) e cila do të synojë në marrëveshjen e bashkëpunimit dypalësh.



### Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

President: *Hysen DOMI*

Sekretar i Përgjithshëm: *Stavri BELLO*

[www.nocalbania.org.al](http://www.nocalbania.org.al)

E-mail: [secretariat@nocalbania.org.al](mailto:secretariat@nocalbania.org.al)

Adresa:

Rruga "Dervish Hima"

Nr.31 Tiranë

Tel:+355 4 235 249 / 240 602

Fax: +355 4 240 565